



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 23

Datë: 06. 09. 2022. Ora: 12: 00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Alim Rama, Arianit Elshani, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
2. Shqyrtimi dhe miratimi i themelimit të ekipit për mbikëqyrjen e zhvillimit të Softuerit të KQZ-së për numërim dhe rezultate.
3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

4. **Kreshnik Radoniqi**: E kemi një pikë të rendit të ditës: “Shqyrtimi dhe miratimi i themelimit të ekipit për mbikëqyrjen e zhvillimit të Softuerit të KQZ-së për numërim dhe rezultate.” A ka dikush diçka lidhur me rendin e ditës ?

Me 8 vota për, miratohet rendi i ditës.

Jemi njoftuar nga OSBE lidhur me Softverin e KQZ –së, është kontraktuar kompania. Janë zhvilluar të gjitha procedurat e tenderimit. Ata, kanë kërkuar nga ne, që sa më parë të formohet ekipi për mbikëqyrjen e këtij Souftveri dhe, ne sot do ta themelojmë ekipin.

Ekipi, do të jetë nga: **Alim Rama, Arianit Elshani dhe Fazli Stollaj** (KQZ), kurse nga Sekretariati do të jenë: **Kreshnik Spahiu, Premtim Rrustemi dhe Besnik Buzhala**. Në ndërkohë, kuptuam se Souftveri

do të ketë edhe një pjesë – çështje që ka të bëjë edhe me ZRPP-në, propozimi im është që **Vesa Xharra** të jetë nga ZRPP...

A pajtoheni me këto propozime, kush është për këtë ekip ?

Miratohet përbërja me 8 vota për...

Të ndryshme !

Kreshnik Radoniqi: Sa u përket rregullave, kërkoj nga Sekretariati që të na i dërgoj të gjitha rregullat: ato që i kemi trajtuar, por edhe ato tjerat...pra, të gjitha që janë përfundimtare...Të caktohet një datë që, do t'ua përkushtojmë vetëm shqyrtimit dhe miratimit të rregullave...

Anëtarët e KQZ-së, u dakorduan që më 26, 27 dhe 28 shtator, të shqyrtohen rregullat...

Edhe diçka: më së largu deri më 23 shtator, duhet ta bëjmë vlerësimin e Kryeshefit...

Ok, mund ta bëjmë vlerësimin përgjatë punëtorisë...

Per KQZ

Kreshnik Radoniqi, kryetar
